



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Mbledhje e përbashkët

*Këshilli për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike
dhe të Drejtat e Njeriut*

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Vasilika Hysi – Zëvendëskryetare e Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me përfaqësues nga shërbimet e profesioneve të lira, shoqatat e biznesit dhe sipërmarrjes.

Marrin pjesë:

Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Ervin Salianji, Bledar Çuçi, Adnor Shameti, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Alket Hyseni, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Ermonela Felaj.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Bashkim Fino, Edmond Leka, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Tom Doshi, Silva Caka, Edmond Haxhinasto.

Të ftuar:

Fatmir Lacej - përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Noterisë

Enila Hasani - përfaqësuese nga Dhoma Kombëtare e Noterisë

Tedi Malaveci, kryetar i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privat

Alban Ruli – kryetari Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve
Gjyqësor Privat

Drita Avdyli - kryetare e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve
Spiro Brumbulli – përfaqësues nga Shoqata Shqiptare e Bankave
Brunilda Kostare - përfaqësuese nga Shoqata Shqiptare e Bankave
Luan Bregasi - Kryetar i Dhomes se Tregtise dhe Industrise Tirane
Nikolin Jaka - Kryetar i Dhomes se Tregtise dhe Industrise Tirane
Gjergji Gjika - Kryetar i Dhomes se Fasonisteve te Shqiperise
Edmond Cami - Kryetar i Dhomes se Tregtise Diber
Florian Piperi – përfaqësues nga ICC Albania
Zak Topuzi - Kreu i Shoqates Shqiptare te Turizmit
Agim Rrapaj – përfaqësues nga Keshilli i Agrobiznesit Shqiptar
Arben Shkodra - përfaqësues nga Bashkimi i Prodhuesve Shqiptare
Luan Leka - sipërmarrës
Fitnete Sulaj - sipërmarrëse
Bardhyl Balza - sipërmarrës
Donika Mici - sipërmarrëse
Avenir Kika - sipërmarrës
Luigj Aleksi - sipërmarrës
Xhevit Hysenaj – sipërmarrës
Erand Rica – sipërmarrës
Kujtim Shkreli – sipërmarrës
Filip Gjoka – sipërmarrës
Faruk Kaba – sipërmarrës
Ilir Mataj – sipërmarrës
Tonin Aliaj - sipërmarrës

HAPET MBLEDHJA

Vasilika Hysi –Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e përbashkët të Këshillit të Legjislacionit dhe të Komisionit të Ligjeve lidhur me seancat dëgjimore të propozuara dhe të miratuara në kalendarin e punimeve të mbledhjes së përbashkët të Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve. Sipas planit të miratuar, ka një sërë seancash dëgjimore lidhur me nismën e depozituar nga kolegë deputetë të Partisë Demokratike në kuadër të konsultimit publik dhe të praktikës së mirë që Kuvendi i Shqipërisë ka për diskutimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme të interesit, të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Kjo është seanca e tretë dëgjimore që zhvillohet. Në vijim do të ketë edhe seanca të tjera jo vetëm në Tiranë, por edhe në qytetet e tjera.

Ju falënderoj, të nderuar të ftuar, që gjetët kohë për të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore.

Besoj jeni njohur me materialin, i cili ju ka ardhur zyrtarisht nga sekretaria e komisionit.

Pa humbur kohë, meqenëse ka shumë të ftuar dhe shumë pjesëmarrje, për procedurë, doja t'ju thosha që ju keni të drejtë të flisni sa të dëshironi, por e mira është të jeni koncizë dhe të paktën në 5 minuta të shprehni mendimet dhe sugjerimet që keni për nismën ose për nene të veçanta të saj. Do ta vlerësonim shumë të paraqiteshin dhe në formë të shkruar.

Ndërkohë, për dijeninë tuaj, Komisioni i Venecias e ka futur në kalendarin e vet nismën dhe besoj brenda muajit dhjetor do të kemi opinionin zyrtar të Komisionit të Venecias.

Faleminderit!

Po, zoti Salianji.

Ervin Salianji – Për procedurë, meqenëse ne jemi propozues, duhen falënderuar pjesëmarrësit e shoqatave të biznesit që kanë marrë pjesë, si Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve dhe Noterisë, biznesi, bankat. Kjo është lista që na është paraqitur nga sekretaria.

Unë kam shumë respekt për të gjithë të ftuarit këtu, por dua t'i them publikut se për shkak të frikës nga vetingu që e ka kapur maxhorancën, Edi Rama e ka thënë qartë që kundërshton mjetet, mënyrën, procedurën, qëllimin e vetingut, është bërë një listë e gjatë për të hyrë në kalendat greke. Pa diskutim që më pas do të kemi bashkimet e sindikatave të

pavarura, profesionistët e kohës së Enverit, pionierët e Enverit që ta shtyjme sa më shumë për hallin e madh që e ka kapur maxhorancën për mosmiratimin e vetingut. Biznesi pa diskutim është kryesori që preket nga lidhjet e krimit me politikën, sepse politika nëpërmjet krimit krijon monopole, krijon konkurrencë të pandershme pa përmendur situatën dramatike ku ndodhet sot Shqipëria, ku biznesit i vendosen gjoba nga banditët që mbështeten qartazi nga qeveria.

Vasilika Hysi – A mund të flisni për procedurë?

Ervin Salianji- Do të vij te procedura.

Vasilika Hysi – Koha për procedurë është 3 minuta.

Ervin Salianji- Ju lutem, mateni kohën!

Është e qartë se maxhoranca nuk e do vetingun e politikës, por qytetarët shqiptarë sidomos pas zbulimit të ngjarjeve të lidhjes së politikanëve me krimin, duan të shkëputen njëherë mirë lidhjet e politikanëve me krimin. Ne si Parti Demokratike kemi kërkuar kontrollin e lidhjeve të tyre me krimin dhe kontrollin e pasurisë së politikanëve. Këto nuk besoj se ka ndonjë qytetar që nuk i do, nuk besoj se ka ndonjë shoqatë që nuk i do, nuk besoj se ka ndonjë akademik që nuk i do, nuk besoj se ka qytetar që nuk traumatizohet kur kryetarë bashkie, të zgjedhur nga Partia Socialiste, thonë unë e njoh Niçen, Cilen, Kaçuben, e të tjerë dhe na i shesin si normalitet lidhjet e tyre me krimin. Nuk besoj se ka qytetarë që nuk preket dhe nuk traumatizohet kur dëgjon që numri 2 i Partisë Socialiste, Taulant Balla, thotë që e kam mik dhe kam udhëtuar 57 herë me një trafikant droge. Nuk besoj se ka shqiptarë që nuk e ka kuptuar atë që kemi thënë ne si Parti Demokratike dhe si opozitë për Arben Ndokën, për Arben Frrokun, për Vangjush Dakon, për Qazim Sejдинin dhe shumë politikanë të tjerë që sot po dalin haptazi si persona të lidhur me krimin. Atë që ne e kemi kërkuar dhe e kërkojmë me forcë sot, që gjendet në përgjimet e prokurorisë dhe përgjimet e partnerëve, që këta zotërinj mund të dënohen, siç edhe ndodhi me ish-deputetët e Partisë Socialiste, mund t'u vijë radha pas 5 vjetësh, 10 vjetësh apo edhe më shumë.

Ne kërkojmë që sot, pa asnjë vonesë, të bëhet kontrolli i integritetit dhe i pasurisë së politikanëve njësoj dhe me të njëjtën mënyrë si me gjyqtarët dhe prokurorët, apo si me gardistët dhe policët e thjeshtë. Nuk ka më vend që politikanët të jenë të privilegjuar në shoqëri, nuk ka më arsye që ne ta shtyjme, ta vonojmë dhe ta fusim, e ritheksoj, në kalendat greke, duke thirrur njerëz gjasme për t'u marrë mendime, për ta shtyrë në pafundësi një proces, për të cilin edhe

kryetari i maxhorancës, zoti Rama, ka thënë se nuk e do, duke kundërshtuar edhe qëllimin, edhe mjetin, edhe gjithçka tjetër.

Sot situata në Shqipëri është dramatike për shkak të revanshit të krimit ndaj institucioneve, ndaj shtetit dhe të përfshirjes së personave të lidhur me krimin drejtpërdrejtë në lidhje me qeverisjen. Biznesi e ndien drejtpërdrejt këtë gjë, sepse tenderat, koncesionet, paratë publike, PPP-të i jepen vetëm një pjesë të biznesit, duke nxjerrë jashtë loje qindra dhe mijëra biznese të ndershme, të cilët duan të punojnë në treg të lirë, në konkurrencë të lirë.

Vullneti i Partisë Demokratike dhe vullneti i opozitës është vullneti i çdo qytetari. Ne duam t'i shkëpusim lidhjet e politikës me krimin 1 orë e më parë, të bëjmë dekriminalizimin e zgjedhjeve, të bëjmë kontrollin me paketën antimafia të çdo biznesi, i cili ka përfituar në mënyrë të pandershme.

Nga ju kërkoj që ky proces të përshpejtohet, jo si teatri që doni ta prishni, të mos bëjmë teatër me qytetarët, duke bërë dëgjesa apo duke përdorur çfarëdolloj marifeti tjetër vetëm për ta shtyrë dhe për ta futur në pafundësi zgjatjen dhe miratimin e vetingut të politikanëve, të cilin e kërkon çdo qytetar shqiptar.

Sot, çdo qytetar shqiptar po i sheh me zë dhe me figurë në përgjimet e prokurorisë, në përgjimet e partnerëve sesi ato që janë thënë prej vitesh po faktohen. Sot do të ishte dita që ju si përfaqësues të maxhorancës, edhe në emër të tyre, të kërkonit ndjesë për ata përfaqësues që i keni futur në parlament dhe që dalin me lidhje të forta me krimin dhe kriminelët.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Salianji!

Të lutem, më dëgjoni, se unë ju dëgjova, edhe pse ishit jashtë procedurës!

Për dijeni, Komisioni i Venecias ka kthyer përgjigje se do ta shqyrtojë në muajin dhjetor dhe përderisa është një institucion europian, i cili e zyrtarizon dhe jep dakordësinë për ndryshimet kushtetuese, e gjithë kjo periudhë deri në muajin dhjetor do të përdoret për të bërë konsultimin publik, për të fituar kohën.

Të nderuar kolegë dhe ju të ftuar, ju kërkoj shumë ndjesë, pasi disave prej jush u është dashur ta dëgjojnë këtë diskutim, mos me thënë recitim, disa herë edhe në aktivitetet e tjera që ka bërë Kuvendi i Shqipërisë.

Do të doja të fillonin menjëherë me dëgjesën, radhën mund ta përcaktoni vetë. Unë kam një radhë që fillon me Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dhomën Kombëtar të Ndërmjetësve,

Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Përmbauesit Gjyqësorë dhe me Shoqatën e Bankave. Nëse dikush prej jush ka ndonjë angazhim dhe kërkon të shprehet më parë, jeni të mirëpritur, prandaj mund ta përcaktoni edhe vetë.

Nëse nuk arrini ta bëni këtë gjë, atëherë do të ndjek radhën sipas regjistrimit që ka bërë sekretaria.

Organizatave që kanë më shumë se dy përfaqësues, do t'u lutesha të flasë një nga përfaqësuesit dhe nëse dikush ka për të shtuar diçka, besoj se ju e keni të qartë, bëhet fjalë për vetingun dhe këtë model kërkojmë ta shtrijmë edhe te biznesi.

Faleminderit!

Nikolin Jaka – Në radhë të parë ju falënderoj për ftesën që na keni bërë dhe ju siguroj që sipërmarrja...

Vasilika Hysi – Ju lutem, prezantohuni!

Nikolin Jaka – Unë jam Nikolin Jaka, kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë të qarkut Tiranë.

Ju falënderoj për ftesën dhe për dëgjuesin, e cila besoj se do të ketë vlerën e vet. Nga ana tjetër shprehim gatishmërinë jo për të qenë pjesë e vetingut, sepse vetingu ynë është bilanci dhe kontrolli i tatimeve, që na kontrollon çdo vit. Ne jemi kundër çdo fenomeni negativ që ndikon negativisht në ekonomi dhe në formalizimin e ekonomisë shqiptare dhe kemi kërkuar fort që qeveria dhe klasa politike të kenë një platformë të qartë kundër informalitetit dhe ekonomisë që favorizohet nga politika. Kështu, në rastin konkret në e shikojmë me shumë interes dhe kërkojmë që të implementohet propozimi i PD-së. Mundësisht kërkojmë të implementohet sa më shpejt për të gjithë klasën politike, sepse përgjegjësia është e të gjithëve, aq më tepër dëmi që i ka shkaktuar klasa politike këtij vendi për 28 vjet është i pallogaritshëm.

Unë dua të bëj një ftesë të hapur që sa më shpejt të procedojmë dhe sa më shumë të dëgjojnë dhe t'i japin argumente palët njëra-tjetrës, aq më mirë është. Edhe ne duhet të ndërjegjësohemi për rolin që kemi dhe do të vazhdojmë të kemi, në mënyrë që ta zhvillojmë këtë vend, sepse realisht ka shumë potenciale dhe shumë mundësi nëse bashkëpunojmë dhe japim argumente.

Në parim jemi dakord me propozimin që të bëhet një veting apo një kontroll i hollësishëm për të gjithë qytetarët shqiptarë që pretendojnë të heqin dorë nga statusi i qytetarit të thjeshtë dhe të kalojnë në pozicionin e shërbimit publik.

Të kalosh në rolin e shërbimit publik, në radhë të parë, duhet të jesh i ndërgjegjshëm për përkushtimin dhe për shërbimin që duhet t'u japësh qytetarëve dhe sipërmarrësve. Nëse kuptohet kjo gjë, unë jam i bindur se edhe klasa politike do të dalë me sukses në realizimin e punës së saj. Jam i bindur se këtu ka shumë që duan të flasin, por Dhoma e Tregtisë shpreh mbështetjen për çdo lloj reforme dhe procedure që shkon drejt kontrollit dhe pastërtisë së figurës të të gjithë klasës politike në Shqipëri. Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Jaka!

A doni të flisni, zoti Luan?

Prezantohuni, ju lutem!

Luan Leka – Quhem Luan Leka dhe president i Bashkimit të Industrive Ushqimore Shqiptare. Konkretisht kompanitë e mia janë: “EHW”, “Conad” dhe “Qafë Shtama”. Unë përfaqësoj kompani, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me tendera, koncesione apo marrëdhënie shitje-blerje me shtetin, pra me kompani që punojnë në treg.

E lexova draftin që na paraqitet dhe, sipas meje, është deri diku interesant dhe i pranueshëm, por lë vend që të shkruhet më mirë apo të përcaktohet më mirë.

Ne, ashtu siç tha edhe zoti Nikolin, paraqesim çdo vit deklaratën tonë të të ardhurave dhe kontrollohemi në çdo kohë nga institucionet e kontrollit, ndaj mendoj se është me vend që të bëhet edhe kontrolli i pasurisë së politikanëve dhe sa kam dijeni unë mund të bëhet. Megjithatë, fakti që është rishkruar në ligj, e përforcon këtë gjë dhe mirë bën, ndërsa lihet vend për t'u diskutuar kontrolli i figurës së politikanëve për lidhje me persona të përfshirë me veprimtari kriminale e të tjerë. Për mendimin tim kjo është evazive dhe lë shteg për abuzim. Ne e konsiderojmë shumë të drejtë kontrollin e figurës së politikanëve, sepse janë njerëz që administrojnë pasurinë publike dhe, pa dyshim, duhet të jenë figura të pastra.

E konsiderojmë të drejtë paraqitjen e deklaratës së të ardhurave dhe pasurisë dhe e konsiderojmë të drejtë që persona të politikës, të dënuar nga gjykatat me vendim të formës së prerë, të mos kenë të drejtë të jenë nesër pjesë e politikës. Gjithashtu, mendoj se duhet riparë neni, që përsëritet në mënyrë të vazhdueshme për kontaktet me personat e tjerë, në mënyrë që të mos lemë interpretime evazive dhe abuzive. Ky është mendimi im për këtë draft.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Leka!

Përfitoj nga rasti t'ju falënderoj edhe për konsulencën dhe për oponencën që u jepni vazhdimisht projektligjeve që kalojmë lidhur me fushën e biznesit!

Prezantohuni, ju lutem!

Luigj Aleksi - Unë quhen Luigj Aleksi dhe përfaqësoj Shoqatën e Ndërtuesve Shqiptarë.

Edhe ne parimisht jemi dakord që të bëhet vetingu, por mënyrën se si, kur dhe ku nuk mund ta shprehim.

Ne mund të japim një mendim që të bëhet sa më e studiuar dhe të mos vuajmë pasojat e asaj që po vuajmë me gjyqësorin dhe me Gjykatën Kushtetuese, e cila ndikon direkt në aktivitetin tonë. Pa hyrë në shtesa të tjera, sepse nuk na takon neve, ato i shikojnë personat e fushës, ne do të ishim të mendimit jo vetëm pastërtia që është thelbësore, por duhet të ketë edhe kushte cilësore që mund të jenë arsimi, kultura, niveli dhe të tjera.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Aleksi!

Filip Gjoka – Përfaqësoj industrinë e bimëve dhe erëzave të Shqipërisë, që merren me përpunimin dhe eksportimin e bimëve mjekësore dhe njëkohësisht jam kryetari i Bashkimit të Prodhuesve të Shqipërisë.

Ne mbështesim iniciativën që është ndërmarrë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për të pastruar figurat që nesër do të jenë në administratën e shtetit dhe në parlament. Ne të gjithë kemi një rreth familjar, dhe nuk duhet t'i marrim të gjithë si në kohën e shokut Enver, që Filipi ka bërë një foto para dy vjetësh me dikë dhe nesër ta përdorim për nevoja të tjera. Unë them që të kemi kujdes me këtë nismë, që të mos pritët druri i njomë duke prerë të thatin, apo nesër duke i marrë nëpër gojë. Këtu jemi mësuar që duke i marrë nëpër gojë ngelet njolla dhe mundësia e pastrimit të këtij personi do të jetë mjaft e vështirë nesër.

Mendoj që ka ardhur koha që në parlamentin e ardhshëm dhe në zgjedhjet e ardhshme t'u jepen fund disa fundërrinave, të cilat kanë hyrë me 5 lekë dhe kanë dalë me 15 lekë. Me gjithë pastrimin e madh që është bërë, ka ende njerëz që nuk po kërkojnë të kandidojnë vetë, por që të fusin njerëzit e afërm që të jenë vegla e tyre. Këtë nuk e meritojnë, pasi shumica jonë ka mbi 27 vjet që punësojmë dhe eksportojmë në këtë vend dhe nesër të jetë në bashki ose në zyrat e shtetit një njeri sharlatan është e padrejtë. Pastrimi do të ishte gjëja më e mirë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Gjoka!

Gjergji Gjika – Përfaqësues i industrisë fasone në Shqipëri.

Ashtu si kolegët e mi, edhe unë shpreh mbështetjen pozitive për këtë projektligj dhe këtë nismë ligjore, sepse ka ardhur koha që edhe politika shqiptare të mos jetë më pjesë e paprekshmërisë, por të jetë njësoj si pjesa tjetër e popullit, e kontrollueshme, më e pastër dhe më e mirë.

Kam bindjen që ky projektligj duhej të ishte pak më i gjerë, jo në sensin e pastrimit, sepse pastrimi është njëra gjë, tjetra është edhe kandidatët që do të vijnë, e përmendi edhe Luigji, të jenë të denjë. Ne jetojmë ndoshta më poshtë se ju dhe i shikojmë se kush po përgatitet dhe kush flet për një problem apo një tjetër, po kështu mediat bëjnë punën e tyre, sepse problemi ka kaluar nga politika deri te policët dhe nëpunësit e thjeshtë, pra situata është agravuar. Prandaj, nëse do të japim një shembull pozitiv me politikën, të jeni të bindur që edhe ata poshtë do të jenë po aq të mirë sa ata që do t'i vendosin apo rekomandojnë.

Duke thënë që projektligji duhet të jetë më i gjerë, kam parasysh që ne duhet të bëjmë edhe dy veprime që janë akute për Shqipërinë dhe që askush nuk i përmend, as politika dhe as medie. Ikja masive e rinisë shqiptare, askush nuk e përmend, sikur është diçka normale. Këtë vit kanë ikur mbi 10% e popullsisë shqiptare, 15% të popullsisë aplikojnë për vizën amerikane dhe mendo që janë kryefamiljarë dhe kanë minimumi 4 veta. Në çdo vend të botës kjo do të ishte një skandal, ndërsa në Shqipëri kjo është normale. E dini përse? Sepse politikanët e kanë hallin te koka e tyre. S'i bie në mendje kujt, por ky është skandal. Të aplikojë gjysma e familjeve shqiptare për të ikur nga ky vend, kjo nuk ka ndodhur kurrë dhe për këtë duhet bërë një projektligj. Ne nuk duhet të bëjmë projektligje vetëm për veten tonë, por edhe për të tjerët. Krahas kësaj, unë e përmenda edhe 4 ditë më parë, ajo s'bëhet me ligj, por me reforma. Është harruar fjala punë dhe njerëzit kanë harruar të punojnë, nuk bëhet gjë pa punë. Të gjitha shtetet, ku ne mendojmë të shkojmë dhe që dikur kemi bërë edhe krahasime me to, janë ngritur vetëm me punë. Struktura të tëra punojnë që ata të cilët punojnë t'i godasin në një mënyrë ose në një tjetër, që është kriminale. Nuk është kriminel vetëm ai që vret. Nuk dua të jap shembuj konkretë, por di shumë raste që nën uniformën e shtetit pengojnë njerëzit që të bëjnë punën e tyre të ndershme. Dje televizori dha një skandal për një biznesmen, i cili ka mbi 500 gra të punësuar në Krujë, e trajtonin si kafshë policët. Kush janë këta policë që i trajtojnë njerëzit kështu?! Është skandaloze, sepse është rrahur në mes të rrugës dhe ne të gjithë rrimë. E keni parë, apo jo?!

Patjetër që nuk e keni parë, sepse po ta shikonit, do të ishit revoltuar si unë. E gjitha kjo ndodhi sepse po i prishnin shtëpinë në tokën e vet, 100 % në hesap të tij. Pastaj pyesim pse s'kemi investitorë të huaj, por partneri italian, që e ka parë atë skenë, është llahtaritur dhe thotë: “Kur rrahin këtë, që është në vendin e tij, mua kushedi se çfarë më bëjnë”. Të gjithë këtë e bën shteti, sepse ai që e bëri këtë ishte me uniformën e shtetit, me koburen e shtetit, me benzinën e shtetit dhe me furgonin e shtetit. Prandaj thashë që kjo duhet të ishte më e gjerë. Më falni që u zgjata.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Gjika, sepse ju ishit aktiv edhe në tryezën për reduktimin e varfërisë!

Lidhur me rastin që ju përmendet dhe është bërë publik, besoj se institucionet përgjegjëse, qoftë mekanizmat e brendshëm, qoftë prokuroria do të hetojnë nëse ka shkelje të ligjit.

Kush dëshiron të flasë?

Donika Mici – Unë quhem Donika Mici, jam CEO e disa fabrikave në Shqipëri prej 27 vjetësh. Përfaqësoj një nga eksportuesit më të mëdhenj në sektorin e këpucëve të industrisë së lehtë dhe mendoj se vetingu në politikë është një nga pikat kyçe që duhet bërë. Duhet parë ligjet dhe nenet, duhet mirëmenduar dhe mirëtrajtuar që të mos ketë vakume për të abuzuar dhe për të pasur vetëm një *show* televiziv. Mendoj se njerëzit janë lodhur duke parë që në asnjë televizion nuk dëgjohet fjala punë, fjala ekonomi dhe nuk ka organizime për të drejtuar dhe për të mirëorganizuar të gjitha politikat ekonomike për të shtuar investimet në Shqipëri. Kështu që unë mendoj se kjo është pika kyçe që politika shqiptare duhet të bëjë. Ne nuk mund të hyjmë në pika delikate, por këto janë punët tuaja që duhet t'i mirëorganizoni dhe mirëtrajtoni, në mënyrë që të ketë sa më pak mundësi të ndërhyhet dhe të abuzohet në këtë drejtim.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit për vërejtjet dhe për sugjerimet, që ne duhet të jemi më të vëmendshëm drejt ekonomisë.

Po, ju lutem!

Faruk Kaba – Quhem Faruk Kaba, kryetar i Shoqatës së Inxhinierëve. Nuk i heq asnjë presje atyre që thanë parafolësit, por personalisht nuk jam njohur me këtë material dhe jo vetëm kaq, pasi unë përfaqësoj veten time, por në të njëjtën kohë edhe shoqatën dhe të paktën bordi i shoqatës sonë duhet të ishte njohur me këtë material. Nuk di çfarë të shtoj më tepër, sepse këtë

material po e shikoj tani që u ula këtu. Sigurisht, e thashë, nuk u heq asnjë presje fjalëve të paraardhësve, i mbështes totalisht. Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Ne kemi kohë deri në muajin dhjetor, sepse presim edhe opinionin e Komisionit të Venecies. Kështu që çdo mendim dhe sugjerim që ju do të keni lidhur me nismën, është i mirëpritur dhe mund ta paraqisni edhe me shkrim.

Faruk Kaba – Në rregull.

Vasilika Hysi – Ne nuk mund të operojmë pa pritur opinionin e Komisionit të Venecies. Prandaj paralel po bëjmë edhe konsultimin publik me aktorët shqiptarë, që të mos kemi vetëm aktorët europianë, por të kemi dhe aktorët shqiptarë.

Faruk Kaba – Faleminderit!

Në qoftë se është e mundur na e dërgoni edhe në formatin dixhital.

Vasilika Hysi – Patjetër, vetëm ju lutem, lini adresën e *email-it*, sepse do të ishit shumë të mirëpritur edhe për nisma të tjera ekonomike ose projektligje që kanë interes, për të cilat do të ishte mirë të ishit të pranishëm.

Urdhëroni!

Zak Topusi – Përshëndetje!

Zak Topusi, përfaqësues i Shoqatës Shqiptare të Turizmit.

Nuk besoj se ka ndonjë shqiptar që nuk është dakord që politika të kalojë në veting, por forma dhe mënyra, sigurisht, që nuk janë pjesë e diskutimeve tona, sepse, në fund të fundit, nuk jemi specialistë për këtë punë. Shikoj se ka disa gjëra që duhen rregulluar. Domethënë, “kur kanë kontakte me persona të inkriminuar” është një fjali shumë e përgjithshme. Unë mund të kem një menaxher, një shef, që mund të dalë nesër i inkriminuar, me të cilin unë kam kontakte të përditshme pune. Kjo e kthen si në sistemin e socializmit, që duhet të kishe frikë mos ti kishe biografi të keqe dhe unë po rrija me ty në një tavolinë apo në një takim. Pra, duhen bërë gjërat më të qarta. Për shembull, t’i mund të gjobitesh aksidentalisht për një proces dhe kjo duhet të të pengojë për të vazhduar politikën. Në rast se dënimi është në lidhje me abuzime të ndryshme, sigurisht që është normale.

Të gjithë jemi dakord që kjo iniciativë të bëhet, por ndoshta duhet detajuar, sepse në një shtet informal nuk besoj se çdo njeri ka blerë shtëpi me dokumente, me çmim të rregullt. Informaliteti nuk është i këtyre dy vjetëve apo i pesë vjetëve, por është i 28 vjetëve. Pra, procesi i

vetëdekarimit duhet të përshkallëzohet, sepse shikoj që mund të penalizohen gjyqtarë për 2 milionë lekë të vjetër apo 2 milionë lekë të rinj, ndërkohë që i tillë është sistem, domethënë, ke marrë për të ndërtuar një shtëpi, por pjesën më të madhe të punëtorëve i ke paguar në të zezë. Sigurisht, nuk i gjen dot më parë, se të paktën që nga viti '92 e këtij, në njëfarë mënyre, u vendosën taksat dhe TVSH-ja.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Zoti Topuzi, këto konsultime publike kanë vlerën e tyre për të shkëmbyer mendime dhe për të dëgjuar shqetësime, të cilat ju i ndieni në punën tuaj të përditshme.

Urdhëroni, zoti Malaveci!

Tedi Malaveci – Përshëndetje!

Jam Tedi Malaveci, kryetar i Dhomës së Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

Dua të them dy fjalë nga këndvështrimi juridik i një profesionisti, që ushtron profesionin e përmbauesit. Këto ditë pamë draftin dhe relacionin shoqërues të projektligjit. Drafti mbështetet vetëm mbi një parim dhe mendojmë se nuk thotë asgjë për modalitetet. Natyrisht, në parim duket bukur dhe i pakundërshtueshëm, madje shkëlqyes, por se si do realizohet nuk gjejmë asnjë detaj të kësaj natyre. Nëse do të bëhet fjalë për proces pastrimi apo rivlerësimi, nuk tregohen organet që do ta bëjnë, të cilat do të duhet të parashikohen në Kushtetutë, siç është bërë edhe me vetingun e prokurorëve dhe gjyqtarëve. Pra, çfarë garancish jep ky draft për mënyrën e zbatimit, të pastrimit apo të rivlerësimit, këtu nuk tregohet. Parimisht nuk mund të shprehet një mendim mbi një parim që s'ka nevojë të diskutohet. Besoj se biem dakord të gjithë për këtë, pasi të gjithë duam një politikë të pastruar, por mungesa e mekanizmave edhe parimin më të bukur dhe më të mirëshkruar e degradon. Ndaj, edhe diskutimi që duhet të shtrojë kjo nismë është: me çfarë mjetes ligjore dhe si do të garantohet e drejta e subjektit. Për sa kohë drafti nuk ka këto elemente, nuk ka si të ketë një nismë. Nuk është nismë të thuash të pastrohet politika, qeveria apo partia, gjykata apo prokuroria. Kjo dihet dhe pranohet. Tashmë kjo është bërë devizë e të gjitha diskutimeve të kohëve të fundit, madje e dy vjetëve të fundit. Nismë është të tregosh se si.

Faleminderit!!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Malaveci!

Nëse do të keni ndonjë mendim konkret me shkrim, jeni të mirëpritur ta depozitoni gjatë ditëve në vijim.

Po, zoti Laçaj.

Fatmir Laçaj – Fatmir Laçaj, zëvendëspresident i Dhomës Kombëtare të Noterëve.

Faktikisht, dispozitat që janë paraqitur (unë mbështes edhe zotin Malaveci) janë shumë të përgjithshme, të padetajuara dhe krijojnë vërtet konfuzion. Në parim, pa dyshim që jo ne, noterët, por edhe një qytetar i thjeshtë do të ishte plotësisht dakord për një pastrim, për një kontroll, pasi shërbimi publik ngjall optimizëm në jetën e një vendi. Ne, duke filluar nga gjyqtarët dhe prokurorët, po e shohim që kemi plot mangësi në këtë drejtim. Fakti që i është dërguar edhe Komisionit të Venecies është pozitiv dhe kuptohet që do të jetë një vlerësim, i cili do të na shërbejë edhe më vonë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Laçaj!

Zonja Avdyli, keni gjë për të shtuar?

Drita Avdyli – Përshëndetje! Unë jam Drita Avdyli, kryetare e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

Parimisht, sikundër edhe parafolësit, shprehem dakord për këtë projektligj. Fakti që Kuvendi apo Komisioni i Ligjeve e ka paraqitur për në Komision të Venecies është një gjë shumë e mirë. Kështu që ne jemi dakord të kalojë sipas procedurave, por duhet nëpërmjet akteve nënligjore të shprehen edhe autoritetet apo masat që do të merren për zbatimin e këtij draftligji.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Fitnete Sulaj – Përshëndetje, zonja Hysi!

Unë jam Fitnete Sulaj, kryetare e Shoqatës së Sigurimeve.

Ju përshëndes të gjithëve, ju dhe parafolësit! Unë e shikoj shumë normale këtë tryezë, por do të ishte më mirë të mblidhej, pasi të kishte ardhur përgjigjja nga Venecia. Ne si industri kemi vuajtur shumë nga informaliteti. Për reformën që është bërë gjej rastin të falënderoj qeverinë dhe ju për ligjin që keni bërë, i cili përsëri gjysmak është, sepse ende nuk janë bërë disa gjëra. Ky veting duhet të bëhet tamam. Kjo do të thotë se ne që kemi qenë të përfshirë në marrëdhënie pune me tregun e sigurimeve, pothuajse tre-katër avokatë kanë qenë aksionerë në këtë treg të sigurimeve, kemi qenë të marrë peng nga gjykimi shumë i keq i gjykatave.

Falënderimet më të mira vijnë nga industria jonë për ndryshimin rrënjësor. Më vjen çudi, se nuk është koha për të bërë veting në politikë, sepse vetingu në politikë është i vetëbërë, përderisa ka instanca ku deklarimi i pasurisë suaj kalon në pasqyrë çdo vit. Kjo duhet parë më shumë, sepse industria jonë nuk ka bërë ndonjëherë evazion fiskal, vetëm devazion fiskal. Ka paguar TVSH-në, në një kohë kur nuk duhet ta paguante. Në të gjithë botën industria e sigurimeve paguan dëmet në byro, që vijnë nga palët e treta dhe janë të paidentifikuara. Kur vjen fundi, ne kemi paguar edhe TVSH-në. Madje, ju që jeni këtu e hoqët një vit TVSH-në dhe pastaj u vendos përsëri taksë. Në një kohë kur kjo industri në të gjithë botën është një nga tri shtyllat kryesore të shteteve, ne kemi mbetur në nivelin e tregtisë së luleve, sepse ka... Kemi ndjesi shumë të keqe, sepse nuk po merret ndokush me ne.

Më vjen mirë për këtë temë që është hapur, por ta dija që ishte zoti Salianji, sinqerisht, nuk do të kisha ardhur.

Flas në emër të sipërmarrjes dhe besoj se do të më mirëkuptojnë. Këta politikanë, kushdo qofshin, të majtë, të djathtë apo të ndërmjetëm, po e marrin peng këtë sipërmarrje, po e marrin peng këtë popull duke sharë, duke fyer...

Dolën disa ligje dhe ju falënderoj shumë, sepse keni shpëtuar gjithë ato familje shqiptare, por merreni edhe një vendim për fyerjet, zonja Hysi, merreni një vendim për media-kazanin, merreni edhe një vendim për ta ndihmuar këtë popull, këtë sipërmarrje.

Njëri nga këta kolegët e mi tha se nuk ka ardhur asnjë i huaj. Si do të vijë një i huaj, more zotëri, kur këtu gjithë ditën flitet kundër njëri-tjetrit?! Flisni, more, një fjalë të mirë, se janë bërë gjithë ato të mira, gjithë ato reforma. Pse nuk e thonë? Le ta thonë. Ne nuk kemi pse të dëgjojmë “Babalen” këtu, se është turp, na fyeni kështu!

Sinqerisht, sot u ndjeva shumë keq, sepse mua më kanë thënë se do të vijmë për dëgjesën për ndryshimet ligjore që mund të futen në Kushtetutë, por jo që do të dëgjoj një njeri që është bërë leckë dhe i ka rënë vlera në zero në opinion.

Ne jemi biznesmenë të sinqertë, të ndershëm, që punojmë me devotshmëri, por edhe në industrinë tonë ka pasur njerëz që kanë qenë pjesë e aksionit në tregun tonë, me informalitet, vjedhje, falsifikime, me gjëra nga më të ndryshmet.

Kam besim te ky parlament dhe te kjo qeveri. Stop një herë e përgjithmonë çdo politikanin që flet keq në Bruksel! Të marrim shembull nga Kosova. Në Kosovë zihen e grihen, por kur vjen puna për në Bruksel, rrinë siç u ka hije. Pse të mos dalë një ligj edhe për këtë? Sepse

kështu na marrin peng dhe nuk vjen një i huaj që ne të mund të investojmë. Jemi të gatshëm për të bërë *partnership*. Ja, ku janë kolegët. Kush do të vijë? “Jo, balancat politike nuk janë në nivelin e duhur”, thonë të huajt. Po pse duhet të shkojmë kështu?! Pse të mos bëjmë një kthesë historike për bashkëpunimin pozitiv-opozitiv, por të mbetemi kështu duke u sharë e duke u grindur? Të mos harrojmë që e keqja e fundit vjen te ne, në një kohë kur ne jemi taksapaguesit më të mëdhenj, që mbajmë këdo që është në karrigen e shtetit.

Kaq kisha.

Ju faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Sulaj, edhe për praninë tuaj në diskutimin e projektligjeve në komision, sidomos në fushën tuaj, të bankave e të tjerë!

Ju kërkoja ndjesë, megjithëse nuk isha unë ajo që fyeva biznesin, por ai është koleg i opozitës dhe ka të drejtën e fjalës. E kanë bërë këtë në çdo seancë. Edhe për ne nuk është gjë e mirë, sepse ju kemi ftuar dhe nuk mund t’ju vëmë në bankën e të akuzuarve. Prandaj, ju kërkoja ndjesë në emër të Kuvendit.

Fitnete Sulaj – Dakord.

Faleminderit!

Vasilka Hysi – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuara zonja dhe zotërinj biznesmenë, me një pjesë të mirë prej jush kam pasur kënaqësinë të njihem dhe të bashkëpunoj. Ne si politikanë, por dhe e gjithë shoqëria, kemi shumë për të mësuar nga eksperiencia dhe mendja juaj. Ashtu siç ju keni realizuar suksesin e biznesit tuaj, synimi ynë është që edhe qeveritë shqiptare dhe shoqëria shqiptare të ndjekë të njëjtën rrugë dhe të jetë e suksesshme.

Ne ju ftuam sot këtu me dëshirën e mirë që çdo propozim, sado i çartur të jetë kur bëhet në procedurën dhe rrugën e duhur ligjore, meriton të diskutohet, ta diskutojmë me ju, sepse kështu na e kushtëzon Kushtetuta dhe ligji. Menduam se kolegët e opozitës së paku do të ishin të gjithë aty për t’ju dëgjuar, edhe pse mbase mund të mos binin dakord me ju. Mbase edhe ne mund të mos jemi dakord me ju, por moralisht dhe ligjërisht duhet t’ju dëgjojmë.

Nga ana tjetër dëshiroj që ju të flisni hapur këtu për atë që së bashku kemi hequr dje, atë përballje të padrejtë dhe të pabarabartë që ju keni pasur në sistemin e drejtësisë. E përmendi zonja, prandaj e mora fjalën.

Drita në fund të tunelit tashmë është e qartë. Jemi akoma shumë larg asaj ku duam të jemi, por nuk jemi në të njëjtat pozita. Unë dua që ta shprehim këtë gjë, sepse nga këtu mund të mësojmë se si mund të bëjmë edhe shumë reforma të tjera. Është kryereforma e drejtësisë ajo që mund të bëjë të gjitha vettingjet. Ky ka qenë synimi që u iniciua kjo reformë. Një mekanizëm i tillë u mendua. Pushteti i drejtësisë mund t'i rregullojë të gjitha pushtetet e tjera. Nëse do të kemi një drejtësi të pavarur, mund të formojmë edhe një ekzekutiv dhe legjislativ të drejtë, sepse çdo akt dhe vendim i tyre do të filtrohet nga kjo drejtësi. Unë mendoj se shoqëria në tërësi do të filtrohet nga drejtësia, prandaj dëshiroj që ju, ashtu siç keni bërë në biznesin tuaj, të vazhdoni punën dhe dhënien e komenteve tuaja pa u ndikuar nga interferenca dhe sugjestionimet politike.

Ju jeni krenarë, ballëlartë dhe të pavarur, ndryshe nga faktorë të tjerë, prandaj unë ju ftoj të mos stepeni dhe të mos prekeni nëse ndonjë etiketë e pavend apo formë e të shprehurit e pavend ju pamundëson dhënien e komenteve tuaja.

Ju faleminderit që jeni sot këtu dhe ne jemi të nderuar që marrim mendimet tuaja!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Hyseni!

Nëse nuk ka njëri tjetër që do të diskutojë, para se t'ju falenderoj, do të doja të ndaja me ju dy informacione që janë me interes për biznesin.

Së pari, në komisionin parlamentar po diskutojmë, pra është futur në procedurën parlamentare, projektligjin “Për noterinë”, për të cilin ka goxha interes nga biznesi, nga kompanitë e sigurimeve, për shkak se kemi vënë si kusht për noterët sigurimin e tyre.

Së dyti, po diskutojmë projektligjin “Për përmbaruesit privatë”. Nëse keni interes, jeni tejet të mirëpritur që draftet që janë depozituar dhe po diskutohen t'i gjykoni dhe të jepni opinionin tuaj.

Së treti, përfitoj nga rasti, meqenëse jeni të pranishëm, Kuvendi ka bërë dje publike në faqen e tij zyrtare kërkesën për regjistrimin e grupeve lobiste dhe të organizatave që dëshirojnë të bashkëpunojnë në Kuvend, të dëgjohen për projektligje. Në bazë të Kodit të ri të Sjelljes së Deputetëve, ne kemi tashmë disa rregulla strikte, si, për shembull, deputetët nuk mund të kontaktojnë drejtpërdrejt me ju për të marrë informacione apo shqetësimet që mund të keni. Pra, vettingun që kërkohet nga opozita ne e kemi filluar tashmë nëpërmjet disa rregullave që kemi përcaktuar në Kodin e Sjelljes, por keni një afat për t'u regjistruar nëse ju do të dëshironi që vitin e ardhshëm të jeni të pranishëm dhe të dëgjoheni për projektligjet që janë me interes për ju.

Do t'ju lutesha që jo vetë ju, por nëpërmjet stafit që ju keni në kompanitë, bizneset apo shoqatat që ju drejtoni, të shikoni linkun dhe të plotësoni formularin, sepse përndryshe do ta keni të vështirë të jeni të pranishëm, sikurse keni qenë sot duke kontaktuar ne ose duke ju telefonuar në mënyrë private.

Siç kuptohet, ne kemi filluar të përcaktojmë rregulla strikte për veten tonë. Të mos harrojmë se ka një sërë nismash që kanë interes. Ndaj, besoj se nga mesi... Sot qeveria kalon projektbuxhetin për vitin 2019 dhe ju ndoshta keni interes të dëgjoheni edhe për projektbuxhetin, edhe për gjithçka tjetër që është në interesin tuaj. Këto ishin dy informacione që dilnin jashtë Këshillit të Legjislacionit, por unë e ndjeva si detyrim t'ju jap, si zëvendëskryetare e Kuvendit.

Do të doja t'ju falënderoja shumë për praninë tuaj!

Keni dhënë mendime të vlefshme. Unë i kam gjykuar dhe i vlerësoj, si relatore e projektligjit së bashku me kolegun Bylykbashi, i cili duhej të ishte i pranishëm sot këtu, që t'ju respektonte dhe t'ju dëgjonte.

Ne po presim edhe opinionin e Komisionit të Venecies. Besoj se deri nga mesi i nëntorit do të vlerësonim shumë të kishim opinionin tuaj për këtë projektligj. E vlerësojmë shumë këtë. Modeli që do të vendoset, ka shumë rëndësi. Ai është një model që ka rëndësi për atë se si do të procedohet më pas, për të bërë atë që ne themi, pastrimin e politikës, të biznesit, të medias dhe të gjithçkaje tjetër.

Gjithashtu, edhe për të hequr edhe ndonjë shqetësim që mund të ketë dikush, i cili mund të pyesë: “Pse jam ftuar unë, si biznes?” Është një kërkesë e Kushtetutës për t'i ftuar të gjithë qytetarët, të gjitha grupet e interesit. Pra, ndryshe nga shqyrtimi i një projektligji, ku ftohen vetëm grupet që lidhen drejtpërdrejt me projektligjin, tani, me ndryshimet kushtetuese, ftohen të gjitha kategoritë.

Javën e ardhshme ne do të kemi një dëgjese me organizatat ndërkombëtare, që operojnë në Shqipëri dhe me shoqërinë civile.

Ndërkohë, kemi bërë dëgjesa me universitetet, me konstitucionalistët, me analistët dhe me profesionistët e fushës.

Edhe një herë, shumë faleminderit!

Jeni të mirëpritur edhe për të adresuar shqetësimet, që ju hasni në punën tuaj të përditshme.

Jeni shumë të mirëpritur për t'u dëgjuar në Kuvendin e Shqipërisë.

Falënderoj edhe përfaqësuesit medias për mbulimin e aktivitetit!

Ju uroj një ditë të mbarë të gjithëve!

Faleminderit, kolegë!